



Në bazë të nenit 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/-040, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr 27/2012 dhe MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe në mbështetje të nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit ,Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.01.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

I

Themelohet Këshilli për Siguri në Bashkësi për komunën e Deçanit me këtë përbërje:

- 1.Kryetari i Komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj (kryesues)
- 2.Komandanti i Stacionit të Policisë në Deçan, z.Nysret Gjurmaj,
- 3.Përfaqësuesi i bashkësisë fetare Islame i Komunës, z.Rasim Bytyqi,
- 4.Përfaqësuesi i Manastirit, z.Petar Rojeviç,
- 5.Zyrtarja për Barazi Gjimore znj. Zoje Sejfiqaj,
- 6.Drejtori i Drejtorisë për Arsimit, z. Qazim Maloku,
- 7.Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës, z.Shefqet Demhasaj,
- 8.Një përfaqësues i FSK-së, z. Xhavit Kelmendi,
- 9.Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike (nuk është i formuar),
- 10.Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z.Gentiana Iberhysaj,
- 11.Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale, z. Izet Zenuni,
- 12.Një përfaqësues nga OJQ, znj.Safete Gacaferi,
13. Një përfaqësues nga mediat Lokale, z. Adem Lushaj,
14. Një përfaqësues i komunitetit të Biznesit, z.Xun Qorraj
15. Një përfaqësues me aftësi të kufizuar, znj.Sabrije Zeqaj,
- 16.Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të Komunës,
- 17.Kryesuesi i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës,
- 18.Një përfaqësues Komunal për Komunitete dhe Kthim, z.Shaban Pejqinoviç,
- 19.Përfaqësuesi i Komitetit RAE ,
- 20.Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z.Nezir Balaj,
- 21.Zyrtari Komunal për koordinimin e takimit të KKS-së, z.Ismet Kukleci,
- 22.Zyrtarja për Informim, znj.Yllarta Thaqi,
- 23.Përfaqësuesi i komunitetit Katolik, z.Don Marjani
- 24.Përfaqësuesi i Drejtorisë së Parkut Nacional “Bjeshkët Nemura”-Jeton Berisha.

II

KKS është trupi kryesor konsultues i komunës për çështje që në bashkëpunim me Policinë dhe përfaqësuesit tjerë,shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë,në të mirë të të gjithë banorëve të komunës.

III

Kryetari i Komunës si kryesues i KKSB i konvokon mbledhjet, përkujdeset për caktimin e rendit të ditës në konsultim me anëtarët tjerë dhe përgatit raportin për Kuvendin e Komunës mbi diskutimet ,konkluzionet,vendimet dhe rezultatet pas secilit takim të mbajtur.

IV

Mandati i anëtarëve të KKSB është i njëjti me anëtarët Kuvendit Komunal.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Deçanit.

VI.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.I-11

Deçan.dt.31.01.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

	
HYRËSE-ULAZNA-IRIGORIS	
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇAN MUNICIPALITY	
Nga: Od: From:	K.K. Deçan AS
Nr. Prot: Br. Prot: Prot. No:	3604
Nr. fazeve: Br. Stranica: No. faza:	01
Data: Datum: Date:	26.02.18
DEÇAN DEÇANE	